

V E N D I M
Nr.36, datë 20.1.2001

PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS NË SHOQËRITË TREGTARE, ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR, QË E USHTROJNË VEPRIMTARINË E TYRE NË SEKTORIN FINANCIAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Paga e drejtorit të përgjithshëm të shoqërive tregtare, me kapital tërësisht shtetëror, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin financiar, “INSIG”, sh.a., dhe “Banka e Kursimeve”, sh.a., përcaktohet nga ministri i Financave, në mbështetje të propozimeve të bëra nga këshillat, drejtuese ose mbikëqyrëse, të shoqërive respektive, të quajtura më poshtë “Këshilla”.

2. Këshillat e shoqërive, të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, përcaktojnë sistemin e pagave dhe të shpërblimeve të punonjësve. Ky sistem të ndërtohet duke iu referuar sistemit të pagave dhe të shpërblimeve të punonjësve në administratën publike. Raporti i pagës minimale me pagën e drejtorit të përgjithshëm të përcaktohet duke iu referuar raportit të pagës minimale me pagën maksimale në administratën publike, por, në asnjë rast, të mos kalojë raportin 1:9.

3. Këshillat i propozojnë ministrit të Financave fondin e shpërblimeve për punonjësit e tyre. Shpërblimet për punonjësit jepen pas nxjerrjes së rezultateve financiare, çdo 3 ose 6 muaj.

Ministri i Financave përcakton shpërblimet për organet drejtuese të shoqërive tregtare, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin financiar.

4. Në pikën 8 të vendimit nr.317, datë 8.7.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për shpërblimin e punës të punonjësve”, fjalët “Drejtori i INSIG”, dhe “Drejtor i Bankës së Kursimeve”, hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta